



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.2550/10 prot

Datë 17.11.2023

**V E N D I M**  
**Nr. 1179/2023**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 17.11.2023, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-83327-10-11-2023, me objekt: “LOT 1 - Blerje Sistem i lëvizshëm C-ARM me detektor dhe panel të sheshtë.”, me fond limit 25,133,333.33 lekë (pa TVSh), parashikuar për t’u zhvilluar në datë 13-11-2023 nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar i Traumës.

**Autoriteti Kontraktor:** Spitali Universitar i Traumës  
Rr. “Lord Bajron” Laprakë, Tiranë

**Ankimues:** Operatori ekonomik “Health & Light” SHPK  
Rruga: “Themistokli Germenji”, Nd 11, H.4, Ap.4,  
Njësia Administrative nr. 2, 1010, Tiranë

Operatori ekonomik “BNT Electronics” SHPK me nipt  
Bulevardi Zhan D'ark, Nd.32, Hyrja 16, Kati 2, Ap.1,  
Tiran

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik

Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”. Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

## **Vëren:**

### **I**

#### *Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomik kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Gjithashtu, KPP konstatoi se ankesat e operatorëve ekonomikë janë paraqitur për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm

I.3. Operatorët ekonomik ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesit kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 12-10-2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-83327-10-11-2023, me objekt: “LOT 1 - Blerje Sistem i lëvizshëm C-ARM me detektor dhe panel të sheshtë.”, me fond limit 25,133,333.33 lekë (pa TVSh), parashikuar për t’u zhvilluar në datë 13-11-2023 nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar i Traumës.

II.2. Në datën 19.10.2023, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, është administruar ankesa me nr. A/2023/3507 ankimi elektronik protokolluar me nr.2550 prot., e operatorit ekonomik “Health & Light” SHPK, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Me anë të shkresës nr. 2791/1 prot., datë 26.10.2023 (të ardhur në sistemin e ankesave elektronike), protokolluar me tonën me nr. 2550/2 prot., datë 26.10.2023 autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik shkresën “Vendimi për ankesën nr. A/2023/3507 datë 19.10.2023” mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ku konstatohet, se e ka pranuar pjesërisht atë.

II.5. Me anë të shkresës nr. 2791/1 prot., datë 26.10.2023 protokolluar me tonën me nr. 2550/3 prot., datë 30.10.2023 autoriteti kontraktor ka ridërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vendimin për ankesën nr. A/2023/3507, datë 19.10.2023.

II.6. Referuar shkresës së sipërcituar të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Health & Light” SHPK dhe e ka njoftuar atë se ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës. Konkretisht, në kthim-përgjigjen e autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka pranuar pretendimet si vijon:

***“[...] 5. Pretendimi Nr. 5 mbi specifikimin "Ndërfaqja Audio (Aux In) dhe sistem të integruar të zërit me altoparlant dhe ndërfaqe".***

*Në ankesën e tij OE shprehet, citojmë: "Këtë specifikim e ka vetem Siemens dhe rrjedhimisht të gjithë prodhuesit e tjerë skualifikohen". Sqarojmë se këto specifikime janë hartuar nga specialistët e fushës dhe synohet garantimi i cilësisë së lartë në procedurat mjekësore ku përdoren. AK ka hartuar specifikimet teknike konform Nenit 36 të Ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik" duke mos përdorur asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces të vecantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patente, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara.*

*Gjithsesi, KSHA gjykon se kërkesa juaj mund të merret parasysh.*

**Sa me sipër, pretendimet e OE do të merren parasysh dhe ky specifikim do të hiqet.**

#### **6. Pretendimi nr. 6 mbi specifikimin “Optimizim digital i dendësisë”**

*Në ankesën e tij OE shprehet, citojmë “Ky është një specifikim tipik që përdoret te Siemens me termin DDO (Digital Density Optimization)”.*

*Sqarojmë se këto specifikime janë hartuar nga specialistët e fushave përkatëse dhe synohet garantimi i cilësisë së lartë në procedurat mjekësore ku përdoren.*

*AK ka hartuar specifikimet teknike konform nenit 36 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” duke mos përdorur asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces të vecantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator specifik ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara.*

Gjithsesi KSHA gjykon se meqë ky proces realizohet edhe në mënyrë automatike, kërkesa juaj mund të merret parasysh.

**Sa më sipër, pretendimet e OE do të merren parasysh dhe ky specifikim do të ndryshohet si më poshtë:**

**"Rregullim automatik dhe manual i kontrastit të ndricimit"**

**7. Pretendimi Nr. 7 dhe Nr. 8 mbi specifikimin "Përcaktim i vlerave gjeometrike dhe të dendësisë":**

Në ankesën e tij OE shprehet, citojmë: "Ky është një specifikim tipik që përdoret te Siemens me termin Stenosis quantification\* Quantification program for geometric and densitometric values"

Sqarojmë se këto specifikime janë hartuar nga specialistët e fushave përkatëse dhe synohet garantimi i cilësisë së lartë në procedurat mjekësore ku përdoren.

AK ka hartuar specifikimet teknike konform Nenit 36 te Ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik" duke mos përdorur asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces te vecantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator Specifik Ekonomik ose ndonjë marke tregtare, patente, tip ose origjine ose prodhim specifik, per te favorizuar ose eliminuar ndermarrje ose produkte te caktuara.

Gjithsesi, KSHA gjykon se kërkesa juaj mund te merret parasysh.

**Sa më sipër, pretendimet e OE do të merren parasysh dhe ky specifikim do të hiqet.**

**8. Pretendimi Nr. 9 mbi specifikimin Pjerresim = (? 220 ?) :**

Në ankesën e tij OE shprehet, citojmë: "Edhe ky është një specifikim tipik i Siemens"

Sqarojmë se këto specifikime janë hartuar nga specialistët e fushave përkatëse dhe synohet garantimi i cilësisë së lartë në procedurat mjekësore ku përdoren. AK ka hartuar specifikimet teknike konform Nenit 36 te Ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik" duke mos përdorur asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces të veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patente, tip ose origjine ose prodhim specifik, per te favorizuar ose eliminuar ndermarrje ose produkte te caktuara.

Gjithsesi, KSHA gjykon se kërkesa juaj mund të merret parasysh.

**Sa më sipër, pretendimet e OE do te merren parasysh dhe ky specifikim do të ndryshohet si më poshtë:**

**"Pjerresim == (? 200 ?)"**

**10. Pretendimi Nr. 11 mbi specifikimin Memorie HDD = 2 TB:**

AK ka hartuar specifikimet teknike konform Nenit 36 te Ligjit 162/2020 "Per Prokurimin Publik" duke mos perdorur asnje marke specifike prodhimi ose burim ose proces te vecante, qe karakterizon produktet ose sherbimet e ofruara nga nje Operator specifik Ekonomik ose ndonje marke tregtare, patente, tip ose origjine ose prodhim specifik, per te favorizuar ose eliminuar ndermarrje ose produkte te caktuara.

Gjithsesi, KSHA gjykon se kërkesa juaj mund te merret parasysh.

**Sa më sipër, pretendimet e OE do të merren parasysh dhe ky specifikim do të ndryshohet si më poshtë:**

**“Memorie HDD= 1 TB”**

[...] Për sa argumentuar më sipër, si dhe në kuadër të frymës së transparencës të cilën legjislatori e synon nëpërmjet legjislacionit të prokurimit publik dhe akteve nënligjore për zbatim të tij, KSHA në respektim të detyrimeve që burojnë nga dispozitat e ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe VKM, nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Komisioni i Shqyrtimit të ankesave i ngarkuar nga titullari i autoritetit kontraktor për shqyrtimin e ankesës dhe dhënien e vendimit:

**VENDOSI:**

***Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Health & LIGHT” SHPK[...]***

**II.7 Komisioni i Prokurimit Publik me Vendimin Nr. Date 01.11.2023 Nr. 1112/2023**

vendosi:

*1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-83327-10-11-2023, me objekt: “LOT 1 - Blerje Sistem i lëvizshëm C-ARM me detektor dhe panel të sheshtë.”, me fond limit 25,133,333.33 lekë (pa TVSh), parashikuar për t’u zhvilluar në datë 13-11-2023 nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar i Traumes.*

*2. Të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.*

*3. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.*

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

**II.8** Në datën 23.10.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike është administruar ankesa me nr. A/2023/3531 ankimi elektronik protokolluar me nr.2574 prot., e operatorit ekonomik “BNT Electronics” SHPK, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

**II.9** Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimesit.

**II.10** Me anë të shkresës nr. 2863/1 prot., datë 27.10.2023 (të ardhur në sistemin e ankesave elektronike), protokolluar me tonën me nr. 2574/2 prot., datë 30.10.2023 autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik shkresën “Vendimi për ankesën nr. A/2023/3531 datë 23.10.2023” mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes, ku konstatohet, se e nuk e ka pranuar atë.

**II.11.** Me anë të shkresës nr. 2863 prot., datë 27.10.2023, protokolluar me tonën me nr. 2574/3 prot., datë 31.10.2023, autoriteti kontraktor ka ridërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik vendimin për ankesën nr. A/2023/3531 datë 23.10.2023.

II.12. Në datën 02.11.2023, Komisioni Prokurimit Publik dërgon shkresë me lëndë “Njoftim për seancë dëgjimore pranë Komisionit Prokurimit Publik” me nr. prot 2550/5 për operatorët ekonomik ankimes “Health & Light” SHPK, Operatorit ekonomik ankimes “BNT Electronics” SHPK dhe Autoritetit Kontraktor.

II.13. Në datën 06.11.2023, Komisioni Prokurimit Publik dërgon shkresë me lëndë “Njoftim për seancë dëgjimore pranë Komisionit Prokurimit Publik” me nr. prot 2550/6, për operatorët ekonomik ankimes “Health & Light” SHPK, Operatorit ekonomik ankimes “BNT Electronics” SHPK dhe Autoritetit Kontraktor.

II.14. Pranë Komisionit Prokurimit publik është depozituar shkresa e Autoritetit Kontraktor me nr. 2390, datë 06.11.2023, protokolluar me tonën 2550/7, datë 07.11.2023, në lidhje me pjesëmarrjen në seancë dëgjimore.

II.15. Në datën 13.11.2023 , ora 12:00, në mjediset e Komisionit të Prokurimit Publik u mbajt seancë dëgjimore me përfaqësues të operatorit ekonomik “Health & Light” SHPK dhe të autoritetit kontraktor “Spitali Universitar i Traumës”.

Në prani të palëve të sipërcituara, në përgjigje të kërkesës së Komisionit të Prokurimit Publik, për sqarim në lidhje me pretendimet e ngritura në ankesë nga operatori ekonomik ankimes “Health & Light” SHPK, për sa i përket specifikimeve teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor, u zhvillua seanca degjimore audio me përmbajtje si vijon:

( Fluroskopi e vazhdueshem ma=15 ma

KPP pyet Autoritetin kontraktor: Si janë specifikimet teknike të pajisjeve objekt - prokurimi në përputhje me nenin 36 të LPP, pra në cilën prej metodave të parashikuara në LPP është mbështetur AK për hartimin e specifikimeve teknike, a ka një standard kombëtar apo ndërkombëtar që AK është mbështetur në hartimin e këtyre specifikimeve teknike, apo bazuar ne funksionalitetin e pajisjes?

*Përfaqësuesit e autoritetit kontraktor sqarojnë se:* për sa i perket kesaj ne kemi ngritur nje KShA dhe ka dhene nje pergjigje qe sipas KShA do te conte ne mangesi te mbedha, shprehet se nuk eshte specilist i fushës. Jemi bazuar ne kerkesat fuksionale, sipas grupit te punes pasi do jene ato qe do i perdorin. Pra anetaret mjeket qe jane ne kete grup do perdorin keto pajisje. *Perfaqesuesi i operatorit ekonomik –* Eshte e pamundur nga ana fizike dhe teknologjike te marre fluroskopi te vazhdueshme, eshte nje pajisje e cila lexon transmeton fshin rilexon dhe kete e ben me nje frekuence te ndryshme ne baze te prodhuesve dhe gjithashtu specifikimi poshte Fluroskopi e vazhdueshme = 30f/s eshte ne kontradite me kerkesen e mesiperme. Kjo nuk ekziston kjo specifikim qe kerkohe.

(Fluroskopi e vazhdueshme”)

*KPP pyet Autoritetin kontraktor -* Ku jeni referuar per Hartimin e Specifikimeve teknike?

Pergjigje Autoriteti Kontraktor - jemi bazuar ne kerkesat funksionale te pajisjeve, kete e ka gjykuar Ksha 15 fr/s, mendoj se nuk eshte cilesi me e mire sesa 30f/s.

KPP pyet Autoritetin kontraktor- Do ta cenonte funksionalitetin e pajisjes n.q.s. vendoset sipas kërkesave te OE?

Autoriteti Kontraktor -30 f/s i bie 30 foto per sekond 15 f/r i bie 15 foto ne sekond, ndoshta edhe mund ta cenoje mendoj.

KPP-Gjate testimi të tregut keni evidentuar faktin, se ky lloj specifikimi gjendet në 2 ose më shumë prodhues, OE.

-AK- Nuk e kemi verifikuar po besoj se ekzistojnë, nuk e kemi bërë këtë verifikim.

-OE- Specifikim shumë i avancuar përdoret për procedura të kardiologjise, kur anatomia ka lëvizje shumë të shpejtë, për një paralelizim në sistemet më të avancuara të fluoroskopise në bote dhe Shqipëri. Sistemet që përdoren në neurologji nuk kanë më shumë se 15 f/s, sepse është e mjaftueshme për të marrë një imazh pa asnjë lloj mangësie klinike.

(Specifikimi: rezolucioni në monitor gjatë grafise = 3.lp/mm në të tëra fushat aktive)

AK- Bazuar në funksionalitetin e makinerise, bazuar në vendimin e KSHA besoj se 3.0lp/mm është më cilësor imazhi se 2.5 lp/mm.

KPP- Do të cenonte funksionalitetin n.q.s. ndryshohet?

AK- JO 100% por besoj, se është më pak cilësore.

OE- Më bindje juaj them se asnjë prodhues nuk ofron 3 lm/mm për të gjitha fushat aktive, por për fusha më të vogla zoom1, zoom2 zoom3, varet si e kanë prodhuesit e ndryshëm, pra ky rezolucion reaziohet me një modalitet pune me zoom. Klinikisht nqs mjeku ka nevojë të shikojë 3 lp/mm mjafton t'i bëjë zoom. Në të gjitha fushat aktive është cenim konkurrence dhe e rende.

KPP-Ky lloj specifikimi a plotësohet nga disa apo 2 prodhues?

AK- Nuk e kemi bërë këtë verifikim.

KPP- A mundet të verifikoni në AK n.q.s. keni bërë një testim tregu dhe plotësohen nga disa OE ose prodhues, dhe të na vendosi në dispozicion dokumentacionin? Ju lihet për detyrë brenda ditës së merkurë brenda afatit zyrtar për të gjitha argumentet me shkrim.

(Rezolucion në monitor gjatë fluorokopise= 3.0lp/mm )

I njëjti qëndrim si më sipër...

### **Kënd i Shikimit horizontal vertikal 178/ 178**

AK- Shprehet se klinikisht kjo ska nevojë për këto specifikime, por këtë kënd shikimi për këtë kënd fiks 178 grad me monitorin ( ky skenar që doktori duhet të jetë 178 grad me monitorin).

OE- sugjeron që m.q.s e kërkon më kënd 178 për shikim optimal, të bëjë lëvizje vertikale 18 cm.

KPP- A do cenonte funksionalitetin ndryshimi i këtij specifikimi teknik?

AK- JO nqs ka dhe spostimin vertikal 18 ckm vertikalisht më mirë, sa më gjere aq më mirë .

(WLAN / WiFi 150 Mbit/s IEEE 802.11 a, b, e, g, h, i, n)

KPP- Mund të na thonë se ku jeni bazuar për këtë specifikim teknik?

Ak- Sipas funksionalitetit të pajisjes.

OE- A keni një sistem PAKSI në Spital dhe a funksionon ky sistem PAKSI në spital, dhe mëndoj se kjo është copy paste, nqs skeni PAKSI kjo EIFI nuk ju duhet fare, pasi nuk ndikon.

AK shprehet se mund të Ky PAKSI mund të vihet një ditë....

Nderfaqe për injektor kontrasti për lidhjen e një injektorit kontrasti – kerkese automatike për Autoritetin kontraktor pas disa parashtrimeve të operatorit ekonomik mbi këtë pretendim.

AK- Mëndoj se jam dakort me Ankimuesin, përdoret ralle dhe në shumicën e specialiteteve që kemi në, vetëm radiologjia mund të përdoret, ndërsa në ortopedi ose kirurgji kjo përdoret shumë ralle ose anjehere. ( Mjek) (PRANIM NGA AK).

II.15 Në datën 16.11.2023, në formë elektronike nëpërmjet e-Mail, është protokolluar shkresa e Autoritetit Kontraktor, me nr. 2550/8, datë 16.11.2023.

II.16 Pranë Komisionit Prokurimit publik është depozituar shkresa e Autoritetit Kontraktor me nr. 3038, datë 15.11.2023, protokolluar me tonën 2550/9 datë 17.11.2023, më lëndë “Informacion plotësues për ankesën A/2020/3507 datë 19-10-2023” .

### III

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

#### **Arsyeton:**

III.1 Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Health & Light” SHPK dhe operatorit ekonomik “BNT Electronics” SHPK, të cilët në mënyrë të përmbledhur argumentojnë se:[...] “

*Argumenti 1 Specifikimi : fluoroskopi e vazhdueshme ma: = 15 ma Sqarim : fluoroskopia e vazhdueshme ka qenë tipike për sistemet me intensifikator imazhi. Ne Ditet e sotme perdoren detektorët e sheshte te cilët nuk mund te punojne me fluoroskopi te Vazhdueshme. Kjo per faktin qe detektori nuk lexon/mbledh informacion gjate gjithë kohës. Detektori merr informacionin de me pas e lexon atë dhe pastaj e fshin de rrjedhimisht nuk merr Informacion te vazhdueshëm. Kesisoj fluoroscopia e vazhdueshme nuk eshte e aplikueshme me kërkesë : kërkojme qe ky specifikim te hiqet sepse nuk eshte pjese logjike e specifikimeve të nje Harku c me detektor te sheshte. Dhe te zëvendësohet me fluoroscopi pulsuese.*

*Argumenti 2 Specifikimi : fluoroskopi e vazhdueshme = 30 f/s Sqarim : i njejtë arsyetim vlen njesoj si për piken e mësipërme. Duhet te jete fluoroskopi Pulsuese. Nga ana tjetër kerkohet te kete 30 frame për sekonde. Ky parametër dihet qe eshte tipik Per ekzaminime kardiake ku kemi levizje te shpejta anatomike, dhe jo për ekzaminime vasculare Apo per ortopedine. Per te cilat eshte me se e mjaftueshme qe te kenë nje numër me te ulet. Kerkese : kërkojme qe ky specifikim te hiqet sepse nuk eshte pjese logjike e specifikimeve te nje Harku c me detektor te sheshte dhe të zëvendësohet me fluoroscopi pulsuese 15 f/s*

*Argumenti 3 Specifikimi : rezolucion ne monitor gjatë grafisë = 3.0 lp/mm ne te tera fushat aktive Sqarim : prodhuesit kanë përqsaje te ndryshme teknologjike ne lidhje me cilësinë e mire te Imazhit me qellim qe te arrijne trajtime te mira de rezultate te mira diagnostike. Kerkese: kërkojme që ky specifikim te ndryshohet ne = 2,5 lp/mm pa zmadhim dhe = 3.0 lp/mm*

*Ne te gjithë fushat e tjera aktive.*

*Argumenti 4 Specifikimi : rezolucion ne monitor gjate fluoroskopise = 3.0 Ip/mm ne te tera fushat aktive Sqarim : prodhuesit kane perqsaje te ndryshme teknologjike ne lidhje me cilesine e mire te Imazhit me qellim qe te arrijne trajtime te mira dhe rezultate te mira diagnostike. Kerkese : kerkojme qe ky specifikim te ndryshohet ne = 2,5 lp/mm pa zmadhim dhe = 3.0 lp/mm Ne te gjithë fushat e tjera aktive.*

*Argumenti 10 Specifikimi : këndi i shikimit horizontal / vertikal 178 ? / 178 ? Sqarim: Ky e eshte nje specifikim thjesht per te larguar konkurrencen dhe eshte tipik për Siemens kërkesë : propozojme qe te bëhet 170 ?/170? Dhe qe te kete mundesi qe te beje edhe lëvizje vertikale prej min 18 cm.*



Argumenti 12 Specifikimi : ËLAN /ëifi 150 Mbit/s IEEE 802.11 a, b, e, g, h, i, n IEEE 802.11 a/b/g/n/ac (2.4 ghz and 5 ghz band) Sqarim : jane specifikime per produkt te caktuar te kompanise prodhuese Siemens kerkese : propozojme qe te bëhet ne IEEE 802.11 a/b/g/n/ac (2.4 ghz and 5 ghz band): APA and APA2, 802.1X (EAP-TLS, PEAP) Argumenti 13 kerkojme qe te hiqen specifikimet e mëposhtme te cilat ne vetvete ngushtojne konkurrencen. - nderfage per injektor kontrasti për lidhjen e nje injektorit kontrasti - kerkese automatike per injektim kontrasti pas marrjes se imazhit Mjeku injekton kontrastin dhe pastaj fillon normalisht punën.

### **BNT ELECTRONICS**

Konkretisht ne ankesë operatori ekonomik ngre pretendime mbi modifikimin e dokumentave si me poshte vijon: "BNT ELECTRONIC" Ne karakteristikat teknike te Generatorit me Rreze X te kesaj pajisje jane parashikuar 2 elemente teper te rëndësishem te cilet behen shkak per kufizimin e konkureses pasi keto karakteristika i perkasin nje prodhuesi te percaktuar dhe konkretisht GE. Specifikimet teknike ne fjale jane: - Generator me frekuence te larte = 50 Hz - Fluoroscopi e vazhdueshme mA: = 15 mA Fillimisht, risjellim ne vemendjen tuaj se firmat prodhuese kryesore ne fushen e prodhimit te pajisjeve mjekesore qe jane boterisht te njohura jane vetem 5 -6. Te gjitha prodhojne pajisje te te njejtit nivel por qe secili nga keto prodhues ka perdorur disa elemente te vecante si specifikime teknike qe kane disa specifikimet te tyre te ndryshme nga njera tjetra dhe qe per pasoje beine dallimin. (Kete ceshtje vecorite teknike qe ka secili prodhues e kemi trajtuar edhe me perpara ne ankesat tona ku ju kemi bere me dije se si vetem nje specifikim teknik nga 100 te tjera te parashikuara, automatikisht determinon prodhuesin dhe per pasoje fituesi e nje procedure te caktuar). Ne rastin konkret, nenvizojme faktin se pasi analizuar me kujdes specifikimet teknike te kesaj pajisje, konstatoam se vecorite (generator me frekuence = 50 Hz. dhe Fluoroscopi e vazhdueshme mA: = 15 mA) perkasin nje produkti /brandi te caktuar, konkretisht brandi GeE (General Electric Healthcare). Duke vendosur kerkesat per Generator me frekuence te larte = 50 Hz dhe Fluoroscopi e vazhdueshme mA: = 15 mA, AK ka kufizuar pjesemarrjen e operatoreve te tjere ekonomik te cilet mund te oftojne kerkesa funksionale he performancen e kerkuar me frekuence generatori dhe Fluoroscopi qe shprehet ne vlera te tjera por arrin performancen e kerkuar apo me te late se sa eshte kerkuar. \*\*\*\*\*Si perfundim kerkoime: ndryshimin e dokumentave te tenderit perkatesisht specifikimeve teknike te behen te hapura si me poshte dhe te lihet e hapur: Generator me frekuence te larte = 40 Hz [...], **Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,**

**III.1.1. Në shtojcën 5 të dokumenteve të tenderit autoriteti kontraktor ka parashikuar specifikimet teknike ne lidhje me pajisjet objekt - prokurimi :**

### **Shtojca 5.**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor ]  
FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të

marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

**SHËNIM:** Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

#### 1. Specifikime teknike për Sistem i levizshem C-Arm me detector me panel të sheshtë:

Sistem i levizshem C-Arm me detector me panel te sheshte

- Detektor i sheshte  $\geq 25 \text{ cm} \times 25 \text{ cm}$
- Tregues lazer i integruar ne detektor i cili prodhon nje kryq
- Madhesia e pikselit  $\leq 185 \mu\text{m}$  jo me i madh
- Dixhitalizimi  $\geq 16$  bit jo me i vogel
- Matrica  $\geq 1500 \times 1400$  piksel
- Grilje  $f_0 = 100 \text{ cm}$
- Mundesi per tre fusha aktive
- **Resolucion ne monitor gjate grafise  $\geq 3.0 \text{ lp/mm}$  ne te tera fushat aktive**
- **Resolucion ne monitor gjate fluoroskopise  $\geq 3.0 \text{ lp/mm}$  ne te tera fushat aktive**

Tensioni ushqyes i pajisjes

- Tensioni ne hyrje me nje faze 220V

Gjeneratori i rrezeve X

- Fuqia maksimale e gjeneratorit  $\leq 15 \text{ k}\ddot{\text{E}}$
- **Generator me frekuence te larte  $\geq 50 \text{ Hz}$**
- Diapazoni I kV 40 kV to 120 kV ose ekuivalent
- Imazh tek mA:  $\geq 35 \text{ mA}$
- **Fluoroskopî e vazhdueshme mA:  $\geq 15 \text{ mA}$**
- Fluoroskopî pulsuese mA:  $\geq 20 \text{ mA}$
- **Fluoroskopî e vazhdueshme  $\geq 30 \text{ f/s}$**

Llampa e rrezeve X

- Llampe me transformator te tensionit te larte me dy fokuse
- Tensioni 120 kV
- Shperndarja e nxehtesise se anodes HU/min:  $\geq 40,000$
- Kapaciteti termik i anodes HU:  $\geq 70,000 \text{ HU}$
- Filtrimi i rrezeve X sipas standardit (IEC 601)  $\geq 3 \text{ mm Al}$
- Matje e integruar e dozës per afishimin e prodhimit doze siperfaqe ose vlere kerma ne ajer
- Opsion qe per cdo pacient vlere e akumuluar te ruhet ne databazen e pacienteve
- Kolimator me kolimim pa rrezatim (plumb)

Sistemi i C-arm

- Levizje orbitale  $\geq 140^\circ$
- Pjerresim  $\geq (\pm 220^\circ)$
- Levizja horizontale  $\geq 20 \text{ cm}$
- Levizja vertikale  $\geq 40 \text{ cm}$  e motorizuar

#### *Monitor sekondar i montuar ne C-ARM*

- Monitor me prekje  $\geq 10$  inch
- Monitor me ngjyra me ndriçim te larte

#### *Afishues/ Monitore*

- Monitor me ngjyra me ndricim te larte 2x19" (48 cm) ose nje monitor  $\geq 40$ "
- Diagonalja e ekranit  $\geq 19$ " (48 cm)
- Shfaqja e imazhit 1280x1024 (pixels)
- Ndricimi maksimal 650 cd/m<sup>2</sup>
- Raporti i kontrastit  $\geq 700:1$
- Teknologjia e preferuar LED me ndricim te pasem
- **Kendi i shikimit horizontal / vertikaln 178 ° / 178 °**

#### *Kareli i levizshem i monitoreve*

- Mundesi per instalimin e dy monitoreve ose nje monitor  $\geq 40$ "
- Dalje USB per te dhenat: USB 2.0
- Nderfaqja Audio (Aux In) dhe Sistem te intergruar te zerit me altoparlant dhe nderfaqje
- Lidhje LAN Gigabit
- **ËLAN / ËiFi 150 Mbit/s IEEE 802.11 a, b, e, g, h, i, n**
- Kabell fuqie  $\geq 5$  m

#### *Hardëare i PC*

- Sistem operacional me 64 bit
- RAM  $\geq 8$  GB
- Karte grafike e nivelit professional e performances se larte per sistemin e detektorit te rrezeve X
- Kapacitet ruajtes per  $\geq 100,000$  imazhe ne hard disk, pavaresisht nga madhesia e matrices
- Te gjithë pacientet e ruajtur ne foldera te vecante
- Memorie HDD  $\geq 2$  TB

#### *Administrimi i te dhenave te pacientit*

- Mundesi (HIS/RIS) per marrjen e te dhenave te ekzaminimeve nga Spitali/radiologjia
- Regjistrim i pacientit te emergjences
- Administrim i studimeve dhe i te dhenave te imazhit
- Regjistrim i imazheve me filtrim dixhital
- Programe te dedikuara me doze te ulet
- "Filter shtese bakri ose alumini per reduktim te metejshem te dozës se pacientit"

#### *Shfaqja e imazhit*

- Shfaqje e imazhit 1k x 1k
- Diafragma dixhitale
- Zmadhim dixhital dhe zmadhim fiks
- Rrotullim dixhital i imazhit
- Zoom I detektorit
- LSH (Last Scene Hold)
- Invertim i imazhit horizontal dhe vertikal
- Invertim i imazhit Positiv/negativ
- Rilujtje e videove of scenes dhe funksion automatik i rilujtjes.

#### *Perpunimi i imazhit*

- Korrektim i metalit
- Filtrim për shfaqjen e imazheve me konture te theksuara
- Theksim i kontureve

- Reduktim i zhurmes
- Optimizim dixhital i dendesise
- Shenim R/L
- Matje te distances dhe te këndit

Programe dhe hardëare te vecanta te kërkua

- Digital Subtraction Angiography (DSA) te perfshihet
- Perftim i imazhit ne Subtraction Angiography (SUB) dhe roadmap (ROAD)
- Teknike Roadmap per udhezim te lehte te kateterit, dilatacionit, dhe vendosjes se stenteve
- Perftim i imazhit deri 30 f/s
- Percaktim i vlerave gjeometrike dhe te dendesise.
- Mbivendosje grafike ne kohe reale
- Opsion i zhvendosjes se pikseleve
- Funksion i matjeve 2D: matje te kendeve dhe distancave.
- Nderfaqje per injector kontrasti per idhjen e nje injektorit kontrasti
- Kerkese automatike per injektim kontrasti pas marrjes se imazhit
- Shfaqje e ndryshimeve dinamike gjate injektimit te kontrastit
- Celes pedal per leshimin e rrezatimit
- Regjistruer CD / DVD per serite e imazheve dhe fluoroskopine ne regjistruer DVD
- DICOM Standard
- DICOM Printim

Garancia: Jo më pak se 1 (Një) Vit.

Sasia: 2 Copë

Paisjet mjekësore të kërkua sa më sipër (ne total) duhet të plotësojnë detyrimisht këto kushte:

- Garanci: Jo më pak se 1 (Një) Vit.
- Pajisjet mjekësore të jenë sipas standarteve CE ose FDA,
- Afati i furnizimit: Brenda dy muajve ose gjashtëdhjetë dite duke filluar nga data e nënshkrimit te kontratës se furnizimit.

III.1.3 Në nenin 36 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” përcaktohet se:

1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkua ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "b" të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "a" të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

III.1.4 Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së *lex specialis*, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Gjithashtu, gjykon, se autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin se, hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës.

Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar, se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore, nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 2 të ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", 2 Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt.

Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. KPP gjykon se, parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara. Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, KPP-ja gjykon se, ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike.

Metoda e parë lidhet me kërkesat funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën. Metoda e dytë mbështet në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve. Metoda e tretë përfshin kërkesat në termat funksionale sipas metodës së parë, por referuar specifikimeve teknike të hartuara sipas metodës së dytë, si një mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, si edhe të të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj" në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë.

Gjithashtu, referuar nenit 42 të Direktivës 24/2014 "Për prokurimin publik" KE, parashikohet se: *"Specifikimet teknike siç përcaktohen në pikën 1 të Shtojca VII do të përcaktohet në dokumentet e prokurimit. Specifikimi teknik përcakton karakteristikat, që kërkohen për një punë, shërbim ose furnizim". Gjithashtu, në nenin 4 paragrafi 38 të ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik" përcaktohet "Specifikime teknike" janë: a) në rast të prokurimit publik të punëve, përmbledhje e të dhënave teknike të përfshira në dokumentacionin e tenderit, me të cilat janë përkufizuar karakteristikat e nevojshme të materialeve, prodhimeve ose mallrave për t'u përshtatur me përdorimin që i duhet autoritetit ose entit kontraktor. Këto karakteristika përfshijnë ndikimin mbi mjedisin jetësor dhe ndikime klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe procedurat për sigurim të cilësisë, terminologjinë, simbolet, metodat e testimit, paketimit, shënimit dhe etiketimit, si dhe udhëzime për shfrytëzim, proceset dhe metodat e prodhimit të objektit. Gjithashtu, këto karakteristika, përfshijnë rregulla nga projekti dhe rregulla për vlerësim të shpenzimeve, kushte për testim, për inspektim dhe për pranim të punëve të realizuara, metoda ose teknika ndërtimore, si dhe të gjitha kushtet e tjera teknike, të cilat autoriteti ose enti kontraktor ka të drejtë t'i përcaktojë në pajtim me rregullat e përgjithshme dhe të veçanta në lidhje me objektin dhe*

*materialet ose pjesët e përfshira; b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuara dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë.”*

Në pikën 1 të Shtojcës VII të Direktivës parashikohet se: *“specifikim teknik”* nënkupton njërin nga sa vijon: b) në rastin e kontratave të furnizimit publik ose shërbimeve, një specifikim në një dokument që përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ose një shërbimi, siç janë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, modelimi për të gjithë kërkesat (përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancën, përdorimin e tyre produkti, siguria ose dimensionet, përfshirë kërkesat që lidhen me produktin në lidhje me emrin nën të cilin produkti shitet, terminologji, simbole, metodat e provës dhe provës, paketimin, markimin dhe etiketimin, përdorues-udhëzimet, proceset e prodhimit dhe metodat në çdo fazë të ciklit jetësor të furnizimit ose shërbimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit;

Në vendimin e GJED Çështja C-368/10 “Komisioni European vs. Mbretëria e Holandës” inter allia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: *“Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.”* Gjithashtu, nga ana tjetër Komisioni i Prokurimit Publik gjen me vend të sqarojë se është në të drejtë të operatorëve ekonomikë që në respekt të nenit 109 e vijues të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” të parashtrojnë pretendime mbi modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit përfshirë edhe specifikimet teknike të procedurës, brenda afatit të përcaktuar në nenin 110 pika 1 të ligjit. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se ligji 162/2020 “Për prokurimin publik” është përafëruar pjesërisht edhe me *Direktivën e Këshillit 89/665/KEE, datë 21 dhjetor 1989 “Mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me zbatimin e procedurave të rishikimit për dhënien e kontratave të furnizimit publik dhe punëve publike”, e ndryshuar*. Numri CELEX 31989L0665, Fletorja Zyrtare e Bashkimit European, Seria L, nr.395, datë 30.12.1989, fq. 33. Në dritën e direktivës, ekzistojnë dy kushte të përmendura në lidhje me qasjen në procedurat e rishikimit (neni 1 (3): “Procedurat e rishikimit duhet të jenë në dispozicion (...) të paktën për çdo person që ka ose ka pasur interes për të marrë një kontratë të veçantë dhe që ka qenë ose rrezikon të dëmtohet nga një shkëlqje e pretenduar”. Në interpretim literal, sistematik dhe teologjik me synim vendosjen në pah të *ratio legis*, mbështetur edhe në parimin e së drejtës *se ratio legis est anima legis*, (qëllimi i ligjit është edhe shpirti i ligjit), interesi i ligjshëm i operatorëve për të paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor si edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duhet të jetë dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i marrë nga autoriteti kontraktor në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik.

III.1.5. KPP-ja gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik, si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces.

III.1.6. Në përputhje me nenin 24 pika 3 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në marrjen e vendimeve mban parasysht, përveç parimeve të përgjithshme të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, edhe parimet e mëposhtme: paanshmërinë në shqyrtimin e ankesave, qëndrueshmërinë në vendimmarrje, ligjshmërinë, shpejtësinë dhe efikasitetin, aksesin, karakterin publik, si edhe parimin e kontradiktoritetit”,

Komisioni, në jurisprudencën e tij, e ka bërë pjesë të standardeve për një proces të rregullt ligjor edhe respektimin e parimit të kontradiktoritetit. Për sa më sipër, parimi i kontradiktoritetit, i parë në këndvështrimin e barazisë së armëve në procesin administrativ, është një evolucion logjik i të drejtës së palës për të marrë pjesë në gjykim dhe për t’u trajtuar në mënyrë të drejtë dhe të barabartë nga një gjyqtar (arbitër) i drejtë dhe i paanshëm, i cili u garanton të dyja palëve të njëjtat mundësi, për të shpalosur provat dhe argumentet e tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në shqyrtimin administrativ, atëherë argumentet e njëjës palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar dhe për rrjedhojë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues dhe ligjor për të garantuar një proces të rregullt ligjor. Ndaj për këtë qëllim, Komisioni i Prokurimit Publik, organizoi një seancë dëgjimore midis përfaqësuesve të operatorit ekonomik ankimues, përfaqësuesve të autoritetit kontraktor pjesë e njësisë së prokurimit që është marrë me hartimin e kriterëve dhe specifikimeve teknike të procedurës objekt-shqyrtimi. Gjatë seancës, në pyetjet drejtuar autoritetit kontraktor, Komisioni gjykoi të nevojshëm sqarimin si mbi metodën e ndërtimit të specifikimeve teknike, por edhe në drejtim të rolit në funksionalitetin e pajisjes të secilës prej specifikimeve teknike të cilat pretendohen nga ankuesi se janë hartuar në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik, si dhe a i shërben funksionalitetit dhe qëllimit të pajisjes hartimi në mënyrë kaq të detajuar i specifikimeve teknike. Gjithashtu, për ankuesin u drejtuan pyetje në drejtim të provueshmërisë së faktit, se përse specifikimet teknike janë hartuar në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik dhe se si këto të fundit mund të ndikojnë në kufizimin e konkurrencës.

II.1.7. Lidhur me pretendimin e ankimesit në lidhje me specifikimin teknik të përcaktuar nga autoriteti kontraktor për pajisjen Sistem i lëvizshëm C-Arm me detector me panel të sheshtë me specifikime -Resolucion ne monitor gjate grafise  $\geq 3.0$  lp/mm ne te tera fushat aktive - Resolucion ne monitor gjate fluoroskopise  $\geq 3.0$  lp/mm ne te tera fushat aktive- Generator me frekuence te larte  $\geq 50$  Hz- Fluoroscopi e vazhdueshme mA:  $\geq 15$  mA- Fluoroscopi e vazhdueshme  $\geq 30$  f/s , Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kriteret/specifikime që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Rrjedhimisht autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret dhe specifikime teknike në lidhje me produktin e kërkuar, por pa përcaktuar kriteret të cilat të çojnë drejt një marke të caktuar, apo që nuk ndikojnë në performancën e produktit, pasi përcaktimet të tilla janë diskriminuese dhe përjashtuese nga pjesëmarrja në procedurë e operatorëve ekonomikë të interesuar. Në asnjë moment autoriteti kontraktor nuk duhet të vendosë kriteret apo të hartojë specifikime teknike të cilat të drejtojnë në një emër të caktuar marke apo prodhuesi, si edhe specifikime teknike të paqarta e konfuze, duke u bërë kështu përjashtues për operatorë të tjerë për një konkurrencë të hapur e të gjerë, bazuar kjo në përcaktimet e legjislacionit për prokurimin publik si më sipër cituar.

KPP gjykon, se sa më sipër arsyetuar, në lidhje me mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike, ritheksojmë se autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas



përshkrimin të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin, se hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse, duke krijuar kushte për konkurim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, si dhe të mos shërbejnë si pengesa për pjesëmarrjen e të gjithë operatorëve ekonomikë të interesuar për të marrë pjesë në një procedurë prokurimi.

Në rastin konkret, autoriteti kontraktor, në lidhje me kërkesat e mësipërme "Sistem i levizshëm C-Arm me detector me panel të sheshtë me specifikime -Resolucion ne monitor gjate grafise  $\geq 3.0$  lp/mm ne te tera fushat aktive -Resolucion ne monitor gjate fluoroskopise  $\geq 3.0$  lp/mm ne te tera fushat aktive- - Fluoroscopi e vazhdueshme mA:  $\geq 15$  mA- Fluoroscopi e vazhdueshme  $\geq 30$  f/s , ka kufizuar pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë të cilët mund të ofrojnë produkte me specifikime të tjera, prandaj kërkesa e operatoreve ekonomikë "Health & Light" SHPK dhe "Bnt Electornics" SHPK për rishikimin e specifikimeve, por pa ndikuar në cilësinë dhe funksionalitetin e tij, është një kërkesë e drejtë, e cila i shërben hapjes së konkurrencës, si dhe qëllimit dhe objektit të kësaj procedurë prokurimi.

Vlen të theksojmë, se autoriteti kontraktor, gjatë seancës dëgjimore, nuk ka argumentuar apo provuar as ligjërisht, as teknikisht, se specifikimet e hartuara prej tij nuk e kufizojnë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, dhe se ndryshimi i tyre ndikon në funksionalitetin e pajisjes dhe në qëllimin e përdorimit të saj. Akoma me tej Komisioni Prokurimit Publik ne drejtim ne pyetjeve nje der pyetjet ishte nese kishin kryer testim tregu gjë e cila i'u la për detyrë Autoritetit Kontraktor për kthim përgjigje ne fome shkresore. Në këto kushte, me qëllim hapjen e diapazonit të zgjidhjeve të propozuara, Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor, duhet të modifikojë specifikimet teknike të mësipërme, duke e hartuar ato bazuar në funksionalitetin që kërkohet, pa përcaktuar parametra fikse, por duke patur parasysh se këto specifikime nuk duhet të cenojnë funksionalitetin e pajisjes ,

Sa më sipër, pretendimet e ankimuesit qëndrojnë pjesërisht

II.2 Lidhur me pretendimet e ankimuesit "BNT Electronics" SHPK në lidhje me specifikimin teknik të përcaktuar nga autoriteti kontraktor: *Generator me frekuence te larte  $\geq 50$  Hz* , Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor si organi përgjegjës për procedurën e prokurimit, ka përgjegjësi të përcaktojë kritere që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit dhe kthim - përgjigjes së autoritetit kontraktor lidhur me këtë pretendim, Ak e ka argumentuar në mënyrë shteruese, pse ky specifikim teknik nuk kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në shkresën 2863 datë 27.10.2023, protokolluar me tonën nr. 2574/3, datë 31.10.2023, duke cituar "*Te gjitha pajisjet qe furnizohen me energji elektrike AC ne Republiken e Shqiperise funksionojne me frekuence 50Hz. Kjo kerkese nuk favorizon asnje prodhues specifik, perkundrazi eshte nje kerkese krejt normale qe pajisjet qe do te furnizohen te jene te pershtatshme per funksionim me rrjetin e energjise ne vendin tone. Nese OE pretendon qe eshte kufizuar gara ne cfaredolloj menyre, atehere ka barrën e proves per te argumentuar pretendimet perkatëse*", Akoma me tej theksojmë se frekuenca nominale në sistemin elektroenergjitik të vendit i cili operon ne menyre sinkrone me rrjetin european të transmetimit ENTSO-E është 50 Hz.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### Vendosi

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Health & Light” SHPK dhe “BNT Electronics” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-83327-10-11-2023, me objekt: “LOT 1 - Blerje Sistem i lëvizshëm C-ARM me detektor dhe panel të sheshtë.”, me fond limit 25,133,333.33 lekë (pa TVSh), parashikuar për t’u zhvilluar në datë 13.11.2023 nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar i Traumes.
  2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në dokumentet e tenderit sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
  3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
  4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Health & Light” SHPK dhe “BNT Electronics” SHPK.
  5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
  6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaïd Myzyri**

